

V E N D I M
Nr.625, datë 29.12.1993

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.153,
DATË 3.4.1993 "PËR KALIMIN E OBJEKTEVE TË MJETEVE KRYESORE TË
NDËRMARRJEVE DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE"**

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.153, datë 3.4.1993, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët "me përjashtim të objekteve e të mjeteve kryesore të institucioneve kulturore" ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët: "me përjashtim të objekteve dhe të mjeteve kryesore të institucioneve dhe ndërmarrjeve të sistemit të kulturës, rinisë e sporteve që nuk janë në vartësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve".

2. Në pikën 2 shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje: "Me urdhër të titullarit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nga institucionet e ndërmarrjet që ka në vartësi në institucionet e tjera e ndërmarrjet brenda sistemit të kulturës, rinisë dhe sporteve".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi